# GREEN CARD KOSOVA

## LEJA PËR QËNDRIM TË PËRHERSHËM NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

### Informata për lotarinë „Green Card"
### Viza e vërtetë për të jetuar dhe punuar në SHBA

## GREEN CARD



**Informacione në lidhje me lotarinë e famshme amerikane "Green Card"**

---

Informatat në këtë broshurë janë përgatitur nga **Green Card Kosova,** për t'iu përgjegjur pyetjeve që ju mund t'i keni rreth Lotarisë "Green Card". Kjo broshurë përfshinë vetëm disa nga pyetjet dhe përgjegjet e bëra dhe kërkuara më së shpeshti. Andaj, nëse keni ndonjë pyetje dhe dëshironi të merrni përgjegje para se të plotësoni aplikacionin tuaj, ju këshillojmë të lexoni broshurën që keni në dorë. Nëse këtu nuk gjeni përgjegjet që dëshironi, atëherë www.usakosova.com është web-faqe ku mund të merrni edhe më shumë informata rreth dhe për Lotarinë "Green Card".

Nëse edhe kjo faqe nuk iu ofron informatat e nevojshme, atëherë kontaktoni Green Card Kosova përmes: e-mail-it apo telefonit (Shih faqen e fundit).

### 1. Çfarë është Green Card-a?

GreenCard-a është një leje e përhershme e qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Poseduesit e GreenCard-ës mund të hyjnë dhe të largohen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës sa herë të duan. Poseduesit e Green Card-ës konsiderohen banorë të përhershëm të SHBA-ve dhe për ta vlejnë taksa dhe tatime të ulëta për të studiuar, sigurimi i plotë shoqëror nga Qeveria dhe shumë përfitime tjera. Poseduesit e GreenCard-ës kanë mundësi të marrin familjet e tyre në SHBA dhe pas 5 viteve mund të marrin nënshtetësinë amerikane.

## 2. Si mund ta marr Green Card-ën?

Emigrimi për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga viti në vit po bëhet më i vështirë. Emigrimi i rregullt zgjatë shumë vite dhe kushton mijëra dollarë amerikan. Mënyra më e lehtë për të fituar një Green Card është përmes lotarisë që organizohet ç'do vit nga Qeveria Amerikane nën titullin "Diversity-Imigration-Act", e cila u ofron pjesëmarrje të lirë dhe kushte te volitshme për të fituar GreenCard-ën pa mundime të rëndomta.

## 3. Çfarë është Lotaria "Green Card"?

Qeveria Amerikane, përmes Lotarisë "Green Card", ç'do vit ndanë 55.000 leje të përhershme qëndrimi në SHBA. Ndarja e këtyre lejeve bëhet përmes një programi të caktuar që ndanë botën në 6 rajone, ku secili shtet pjesëmarrës fiton një numër të caktuar lejesh. Koha për aplikim është shumë e shkurtër dhe rregullat e kërkuara nga Qeveria Amerikane duhet të respektohen në mënyrë strikte. Koha për aplikim nuk publikohet shpesh dhe shumë lojëtarë diskualifikohen sepse nuk dorëzojnë aplikacionet e tyre me kohë. Një kosovarë lejohet të dorëzojë vetëm një aplikacion në vit dhe ka mundësi të ri-aplikojë nëse nuk fiton.

## 4. Përse është bërë kjo nga Qeveria Amerikane?

Për të pasur një kombinim më të mirë të personave që hyjnë në Amerikë, në vitin 1990 Qeveria Amerikane vendosi të legalizoj "Diversity Immigration Act". Pjesë e këtij legalizimi është edhe Lotaria për Green Card. Ç'do vit dihet, se sa njerëz nga cili kontinent i botës do të hyjnë në Amerikë. Përzgjedhje e njerëzve do të bëhet përmes lotarisë. Personat që kanë lindur në Evropë kanë shanset më të mëdha për të fituar në krahasim me shtetet e kontinenteve tjera.

## 5. Si mund të kualifikohem?

Së pari, ju ose bashkëshorti/ja juaj duhet të keni lindur në vendin që ka të drejtë të merr pjesë në lotari. Vendet që kanë të drejtë të luajnë në lotari janë të gjitha vendet e botës, me përjashtim të këtyre shteteve: Kanada, Kina, Kolombia, Republika Dominikane, El Salvadori, Haiti, India, Mexiko, Pakistani, Filipinet, Korea Jugore, Britania e Madhe (përjashim bënë Irlanda Veriore) dhe Vietnami. Personat që kanë lindur në Hong Kong SAR dhe Taiwan kualifikohen.

Në këtë drejtim vendlindja është kriteri kryesor që vlenë për lotari. Vendbanimi dhe nënshtetësia janë të parëndësishme. Nëse keni lindur në një vend që nuk ka të drejtë të marr pjesë në lotari, por prindërit tuaj nuk kanë lindur në të njëjtin vend, atëherë edhe më tutje mund të kualifikoheni. Në raste të tilla kontaktoni Zyrën Qëndrore të Green Card-ës në Prishtinë.

Së dyti, ju duhet të posedoni diplomën e shkollës së mesme ose dy vite përvojë pune në një pozitë që kërkon dy vjet trajnim apo përvojë. Në SHBA aplikohet Ligji i Punës dhe nëse jeni të pasigurt për kualifikimin tuaj kontaktoni Green Card Support Service në Prishtinë. Për t'u përzgjedhur nuk nevojitet ndonjë shumë tjetër e të hollave, ndonjë sponzor apo dhënia e ndonjë testi.

## 6. Përse këto shtete nuk kanë të drejtë të konkurojnë?

Shtetet e përfshira në listën e mësipërme gjatë 5 viteve të fundit kanë dërguar mbi 50.000 persona në SHBA. Shumica e tyre kanë shkuar atje përmes bashkimit familjarë. Për këtë arsye personat nga këto shtete nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në lotari. Nuk egziston ndonjë arsye politike për këtë ndarje.

## 7. A mund të aplikojnë personat që jetojnë në SHBA?

Po, personat që jetojnë në SHBA mund të aplikojnë për Green Card pa marrë parasysh ku gjenden, çfarë vize të përkohshme posedojnë dhe cilën zyrë shfrytëzojnë për të aplikuar.

## 8. Unë nuk i përmbushi kushtet për të aplikuar ende. Çfarë mund të bëj?

Kërkesa për shkollim ose trajnim dy vjeçar kërkohet dhe vlerësohet nga Autoritetet Amerikane. Nëse i përmbushni kërkesat merret parasysh aplikacioni juaj. Nëse nuk i plotësoni kërkesat dhe jeni më i ri se 21 vjeç, atëhere prindërit tuaj mund të mbushin një aplikacion dhe ata mund të ju përfshijnë ju në të njëjtin aplikacion. Nëse familja juaj fiton edhe ju do të merrni një Green Card pa pasur nevojë të dëshmoni për shkollimin apo kualifikimin tuaj.

## 9. Çfarë të dhënash nevojiten për të plotësuar aplikacionin?

Qeveria Amerikane pret që vetëm personat që iu takojnë vendeve që kualifikohen do të aplikojnë, andaj shtetësia juaj do të verifikohet në rast se ju përzgjedheni fitues. Ne kërkojmë vetëm të dhënat thelbësore që kërkohen në formular. Vetëm fituesit e përzgjedhur duhet të dorëzojnë edhe informata tjera dhe Zyra jonë në Prishtinë do bëjë procesimin e mëtutjeshëm gratis për të gjithë klientët.

## 10. Çfarë bëhet me familjën time?

Bashkëshorti/ja dhe fëmijët nën moshën 21 vjeçare do të marrin Green Card-ën personale. Lidhjet tjera shoqërore nuk njifen nga Qeveria Amerikane. Çiftet e pamartuara duhet të aplikojnë ndaras dhe nëse ndonjëri prej tyre fiton atëherë përmes martesës mund të fitojnë të dy Green Card-ën . Green Card Kosova në këto raste gjithnjë këshillon që secili person të aplikojë për vete dhe në këtë mënyrë edhe mundësia për të fituar do të dyfishohet. Fëmijët mbi moshën 21 vjeçare mund të aplikojnë ndaras nëse i plotësojnë kushtet.

## 11. Çfarë janë shanset për të fituar?

Green Card Kosova nuk ka asnjë ndikim në përzgjedhjen e fituesve. Por, Zyra në Prishtinë mund t'iu garantoj se do të dorëzoj aplikacionin tuaj në rregull dhe në kohë të duhur. Ç'do vit më shumë se një e treta e aplikuesve diskualifikohen për shkak të gabimeve të vogla dhe vonesës. Green Card Support Service ka pasur shkallën 7% të fituesve dhe pritet që kjo përqindje të rritet në vitet e ardhshme, për këtë ngritje do të ndikojë zyra jonë.

## 12. Pse duhet të përdori Zyrën Green Card Support Service?

Zyra jonë posedon njohuritë më të mira në lidhje me emigrimin në SHBA. Ne garantojmë dorëzimin e të gjitha aplikacioneve në formë të rregulltë dhe me kohë. Green Card Support Service asiston edhe për marrjën e Green Card-ës pasi klientët e zyrës sonë shpallën fitues dhe kemi përqindjën prej 100% për marrjën e Green Card-ave të fituara. Gjithashtu i njoftojmë të gjithë klientët me rezultatet e lotarisë dhe iu ofrojmë edhe mundësinë për të ri-aplikuar për Green Card me një çmim special, në rast se nuk përzgjedhen.

## 13. Çfarë bëhet me aplikacionin tim?

Green Card Support Service përdorë një program special për të dhëna, ku plotëson të dhënat tuaja dhe i proceson ato tutje për lotari. Pas disa javësh, pasi ta keni dorëzuar aplikacionin dhe bërë pagesën, ju do të merrni aplikacionin tuaj të plotësuar nga ne, për ta rishikuar dhe nënshkruar. Kur ta ktheni këtë aplikacion tek ne për të dytën herë, duhet të bashkangjitni edhe një foto të formatit të pasaportës. Bazuar në suksesin tonë gjatë viteve të kaluara përmes kësaj procedure, mundësia që të diskualifikoheni për shkak të ndonjë gabimi është zero.

## 14. Çfarë çmimi duhet të paguajmë për shërbimin tuaj?

Procesimi fillestar për lotarinë e Green Card-ës, nga viti 2010, do të bëhet pa pagesë nga Green Card Support Service. Nëse përzgjedheni fitues, atëhere duhet të paguani çmimet për shërbimet e zyrës sonë, si dhe ato për ekzaminim shëndetësor dhe për procesim të Green Card-ës që kërkohën nga Qeveria Amerikane.


**GREEN CARD SUPPORT SERVICE**

**KOSOVË – ZVICËR – AUSTRALI – ZELANDË E RE – AFRIKË JUGORE FRANCË – TAJLANDË – LICHTENSTEIN – POLONI – GJERMANI**

**Zyra në Prishtinë**

**Green Card Kosova**
**Rr. Eqrem Qabej Nr. 112**
**(përballë Fakultetit Filologjik)**
**10000 Prishtinë**
**Republika e Kosovës**

**Tel: +377 (0)44 151 335**
**Ose: +386 (0)49 151 335**

**E-mail:**
**info@usakosova.com**
**www.usakosova.com**

**Numri i biznesit:**
**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**
**70181902**

**Zyra Qëndrore në Zvicër**

**Green Card Support Service**
**Erlenring 7**
**CH-6020 Emmenbrücke**
**Switzerland**

**Tel/Fax:**
**0041412820454**

**E-mail:**
**info@gcss.ch**
**www.greencards.ch**

**Numri i biznesit:**
**Trade Register Luzern**
**SHAB Nr. 154, faqe 4795**



**© GREEN CARD SUPPORT SERVICE KOSOVA, 2010**

**FORMULARI PËR APLIKIM** Ju mund ta përdorni edhe kopjen për të aplikuar. **PRV2010K1409**

## Green Card Support Service

Ju lutemi shkruani rrjedhshëm dhe dërgojeni formularin në këte adresë:

**GREEN CARD KOSOVA, Rr. Eqrem Qabej Nr. 112, 10000 Prishtinë (përballë Fakultetit Filologjik)**
**Tel. +377 (0)44 151 335 ose +386 (0)44 151 335**

Për **secilin** person të përfshirë në këtë formularë duhet të sjellni një foto të formatit të pasaportës. Shikimi drejt kamere dhe prapavija e bardhë e ndritshme.

Aplikoj për lotarinë Green Card. Kujdes!: Bashkëshorti/ja dhe fëmijët nën 21 vjeç të përfshihen në të gjitha rastet.

☐ Kam përfunduar 12 vite shkollë, ose

☐ Gjatë 5 viteve të fundit kam punuar në një pozitë pune që kërkon 2 vite përvojë apo trajnim 2 vjeçar.

☐ Zotëri ☐ Zonja Mbiemri ____________

Emri ____________ Datlindja |_|_|_|_|_|_|_|_|

Vendi i lindjes ____________ Rajoni i lindjes ____________

Shteti i lindjes ____________ Kombësia ____________

Rruga, Nr. ____________ Telefoni ☎ ______ / ______

Fax / E-Mail ____________

KP |_|_|_|_|_| Qyteti ____________ Shteti ____________

Bashkëshorti/ja
Mbiemri ____________ Emri ____________ Datlindja |_|_|_|_|_|_|_|_|
Vendi i lindjes ____________ Rajoni i lindjes ____________ Shteti i lindjes ____________

1. Fëmiu,
Mbiemri ____________ Emri ____________ Datlindja |_|_|_|_|_|_|_|_|
Vendi i lindjes ____________ Rajoni i lindjes ____________ Shteti i lindjes ____________

2. Fëmiu,
Mbiemri ____________ Emri ____________ Datlindja |_|_|_|_|_|_|_|_|
Vendi i lindjes ____________ Rajoni i lindjes ____________ Shteti i lindjes ____________

3. Fëmiu,
Mbiemri ____________ Emri ____________ Datlindja |_|_|_|_|_|_|_|_|
Vendi i lindjes ____________ Rajoni i lindjes ____________ Shteti i lindjes ____________

Nëse keni **më shumë se 3 fëmijë**, ju lutemi shkruani prapa.

| | |
|---|---|
| Procesimi fillestar i këtij aplikacioni bëhet pa pagesë nga ana e Green Card Kosova! | Nëse shpalleni fitues në fazën fillestare të aplikimit, atëherë duhet të paguani për procesimin e aplikacionit tuaj tutje nga Green Card Kosova, shumën prej €750! |

Duke iu përgjegjur pyetjes së mëposhtme na ndihmoni t'i mbajmë çmimet e ulëta: Si keni dëgjuar për ne?

☐ Përmes shtypit ditor dhe kësaj gazete: ____________

☐ Përmes shoqërisë apo të afërmve ☐ Internetit ☐ Pllakatave ☐ Radios ☐ TV-së

☐ Ndryshe...........Si? ____________